

Njoftim aplikimi për rinovim licence

Në zbatim të nenit 43, pika 1 dhe 136, pika 2, e ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 19, pika 1, germa ”a”, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe nenit 10, pika 8 dhe 9 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, njoftojmë se shoqëria “NOA ENERGY TRADE” shpk ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Në mbledhjen e datës 18.08.2026, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë në këtë veprimtari.

Ftohen palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim në lidhje me kërkesat për rinovim licence, brenda 10 (dhjetë) ditëve (nga data 20.08.2026 deri më 31.08.2026) pranë zyrave të ERE-s, në adresën: në adresën: Rruga “Irfan Tomini”, Njësia Administrative Nr. 7, Tiranë, ose në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al.